



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

626-23-11039-5-2-1/C157

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

Grupi i Operatorëve Ekonomik TRIANGLE SH.P.K. rr. Brigada 123, me numër të biznesit: 810048167 selia në Suharekë dhe EING COM SH.P.K. rr. Vëllezërit Podvorica p.n. me numër të biznesit: 810177536 selia në Podujevë të cilët në bazë të marrëveshjes së grupit i përfaqëson z. Arian Bytyqi në cilësinë e Drejtorit të O.E. TRIANGLE SH.P.K. (në vazhdim "Kontraktori"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për Punët e riparimit/mirëmbajtjes si në vijim:

Rregullimi, mirëmbajtja dhe renovimi i asfaltit, kanalizimit dhe rrugëve me kubëza në rrugët Kisha-Cumhuriyet-Bahcelik-Huryet-Asker-Demirci dhe Kultur me numër identifikues: 626-23-11039-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-23-025-5-2-1.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim: **Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me asfalt, rrugëve me kubëza dhe rrugëve tjera si dhe kanalizimeve në Mamushë, në të cilat do të kryhen punët e mirëmbajtjes, rregullimit dhe punët e riparimit në rrugët Kisha-Cumhuriyet-Bahcelik-Huryet-Asker-Demirci dhe Kultur si më poshtë:**

Rregullimi dhe renovimi i asfaltit, kanalizimit dhe rrugëve me kubëza në rrugët Kisha-Cumhuriyet-Bahcelik-Huryet-Asker-Demirci dhe Kultur			
PUNËT E RREGULLIMIT DHE RENOVIMIT			
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia e përafërt indikative për 36 muaj

1	Pastrimi me makine i shtreterve te lumenjeve. Pastrimi duhet te jete I plote duke formuar profilin e meparshem te shtratit, duke perfshire pastrimin e mbetjeve dhe vegjetacionit ne shtratin e lumit. Pastrimi duhet te behet ne ate menyre qe pamja e shtratit te lumit te duket e pastert dhe estetike. Ne qmim te perfshihet edhe ngarkimi i mbetjeve dhe transporti deri ne deponine e caktuar nga inspektorati komunal. Te rastet kur lumi qe pastrohet gjendet perskaj rruges apo trotuarit ekzistues, te llogaritet qe pas perfundimit te punes te pastrohet edhe rruga-trotuari me uje te pastert me presion. Ne qmim te perfshihet edhe sinjalizimi i duhur per devijim te trafikut.	m ²	12,000.00
2	Prerja e lisave dhe drunjeve te tjere te cilet paraqesin rrezik per banoret dhe mjedisin ne pergjithesi, pastrimi i rrugeve lokale dhe trotuareve nga shkurret dhe drunjet skajor. Ne qmim te perfshihet edhe ngarkimi i mbetjeve dhe transporti deri ne deponine e caktuar nga inspektorati komunal. Ne qmim te perfshihet edhe sinjalizimi i duhur per devijim te trafikut.	m'	1,200.00
3	Pastrimi me makine dhe dore i kanaleve te hapura atmosferike me gjeresi deri ne 2m. Pastrimi duhet te jete I plote duke formuar profilin e meparshem te kanalit te hapur atmosferik, duke perfshire pastrimin e mbetjeve ne kanale si dhe vegjetacionin. Pastrimi duhet te behet ne ate menyre qe pamja e kanalit te hapur te duket e pastert dhe estetike. Ne qmim te perfshihet edhe ngarkimi i mbetjeve dhe transporti deri ne deponine e caktuar nga inspektorati komunal. Te rastet kur prroi pastrohet perskaj rruges apo trotuarit ekzistues, te llogaritet qe pas perfundimit te punes te pastrohet edhe rruga-trotuari me uje te pastert me presion. Ne qmim te perfshihet edhe sinjalizimi i duhur per devijim te trafikut.	m'	750.00
4	Te mirëmbajtja dhe te rregulloj kanalizimin e ujërave fekale, ne rast te bllokimit duhet te behet zhblokimi dhe funksionalizimi i rrjetit sipas kërkesës se menaxherit te projektit. Gypat janë me diametër prej Ø400mm deri Ø1000mm	m'	3,500.00
5	Te mirëmbaje dhe te rregulloj rrjedhën e ujërave atmosferike, hapjen e kanaleve sipas kërkesës se menaxherit te projektit. Gypat janë me diametër prej Ø400mm deri Ø1000mm	m'	1,500.00

6	Te bej pastrimin dhe mirëmbajtjen e pesetave te kanalizimit fekale dhe atmosferik sipas kërkesës te menaxherit te projektit	copë	75.00
7	Te bej pastrimin dhe mirëmbajtjen e grilave te kanalizimit atmosferik sipas kërkesës se menaxherit te projektit	copë	80.00
8	Shërbime me ekskavator sipas menaxherit te projektit me makineri përkatëse te rende-ekskavator mbi 16 ton, me ngarkim dhe bartje te dheut deri ne deponinë e investitorit	Orë pune	350.00
9	Pastrimi I mbeturinave te ngurta dhe gjëseneve te forta si dhe atyre te buta(organike dhe joorganike)nga deponit ilegale ne tere territorin e Komunës se Mamushës si dhe largimi I tyre deri deponinë me largësi 5 km.	m ²	15,500.00

PUNËT E KANALIZIMIT

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia e përafërt indikative për 36 muaj
1	Prerja e asfaltit ekzistues (varësisht nga diametri i gypit), hapja e kanalit,demolimi i gypit ekzistues te demtuar ngarkimi si dhe transporti ne deponin legale. Pas përfundimit te kanalit te behet vendosja e gypit dhe mbushja me shtresa te zhavorrit me ngjeshje mbushja e hapesires rreth gypave me rere 0-8mm si dhe perfundimin mbi gypa me zhavor te gurethyesit 0-31.5mm me trashesi dhe gjeresi sa kanali.duke perfshire edhe ngjeshjen graduale te tij ne shtresa 30cm,furnizimi dhe vendosja ne pjesën e kanalit te riparuar me asfalt te gatshëm AB016 me t=11cm.	m ²	4,500.00
2	Demolimi i kubezave ekzistues (varësisht nga diametri i gypit), hapja e kanalit,demolimi i gypit ekzistues te demtuar ngarkimi si dhe transporti ne deponin legale. Pas përfundimit te kanalit te behet vendosja e gypit dhe mbushja me shtresa te zhavorrit me ngjeshje mbushja e hapesires rreth gypave me rere 0-8mm si dhe perfundimin mbi gypa me zhavor te gurethyesit 0-31.5mm me trashesi dhe gjeresi sa kanali.duke perfshire edhe ngjeshjen graduale te tij ne shtresa 30cm,furnizimi dhe vendosja ne pjesën e kanalit te riparuar me kubezat ekzistuese .	m ²	2,500.00

3	Germimi per hapjen e kanalit,(varësisht nga diametri i gypit), hapja e kanalit,demolimi i gypit ekzistues te demtuar ngarkimi si dhe transporti ne deponin legale. Pas përfundimit te kanalit te behet vendosja e gypit dhe mbushja me shtresa te zhavorrit me ngjeshje mbushja e hapesires rreth gypave me rere 0-8mm si dhe perfundimin mbi gypa me zhavor te gurethyesit 0-31.5mm me trashesi dhe gjeresi sa kanali. duke perfshire edhe ngjeshjen graduale te tij ne shtresa 30cm	m ³	6,000.00
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të brinjezuar SN4 HDPE		
4.1	Ø250mm	m'	300.00
4.2	Ø315mm	m'	300.00
4.3	Ø400mm	m'	300.00
4.4	Ø500mm	m'	650.00
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të betonit		
5.1	Ø400mm	m'	300.00
5.2	Ø500mm	m'	300.00
5.3	Ø630mm	m'	300.00
5.4	Ø800mm	m'	300.00
5.5	Ø1000mm	m'	250.00
6	Sigurimi i kanalit me pahi mbrojtëse nga shembjet e dheut me punim sipas detalit në projekt.	m ²	10,500.00
7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për pusetat e kolektorit kryesor dhe pusetat e ujëmbledhësve, me betonarme C20/25	m ³	75.00
8	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta te pusetat e kolektorit kryesor, me përpunim sipas detalit me betonarmC25/30.	m ³	55.00
9	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave te betonarmesë per puseta prej betonit Ø1000/1000mm(elemente te parafabrikua).	copë	200.00
10	Furnizimi, transporti, ndërtimi dhe montimi i konuseve për puseta prej betoni Ø1000/700/600mm(elemente te parafabrikua).	copë	95.00
11	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave prej betonit te armuar Ø400/1000mm(elemente te parafabrikua), për formimin e pesetës se ujëmbledhësit.	copë	80.00
12	Punimi dhe montimi i shkalleve prej armature Ø20 ne çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre ne beton me lyerje antikorrozive.	copë	200.00

13	Furnizimi, transporti, montimi i kapakëve nga materiali kompozit, ne aftësi mbajtëse 40 t me diameter Ø60. Ne çmim te llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betoni C20/25.	copë	95.00
14	Furnizimi,transporti, montimi i grilave nga materiali kompozit, me aftësi mbajtëse 40t me dimenzonet 40x40 cm. Ne çmim te llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonit C20/25.	copë	15.00
PUNËT E RRUGËVE			
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia e përafërt indikative për 36 muaj
1	Prerja e asfaltit ekzistues, demolimi, ngarkimi si dhe transporti ne deponinë legale.	m ²	2,700.00
2	Furnizimi, punimi i shtresës stabilizuese me material jo-koherent të granular (Mv≥50MN/m ²) të trupit të rrugës 0-100mm me trashësi t=50cm me CBR>15%, sipas kërkesës se menaxherit te projektit	m ³	4,000.00
3	Furnizimi, punimi i tamponit (Mv≥60MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-64mm me trashësi t=25cm dhe ngjeshja me cilindër mbi 25 ton sipas stanadarteve dhe rregullave teknike, sipas kërkesës se menaxherit te projektit	m ³	2,800.00
4	Furnizimi dhe punimi i tamponit (Mv≥70MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5 mm me trashësi t=15cm dhe ngjeshja me cilindër mbi 25 ton sipas stanadarteve dhe rregullave teknike, sipas kërkesës se menaxherit te projektit	m ³	1,800.00
5	Furnizimi dhe spërkatja me emulsion e sipërfaqes punuese para asfaltimit	m ²	3,000.00
6	Furnizimi,transporti dhe punimi i shtresës së asfaltit binder (0-22) mm BZH22, me trashësi t=7.0 cm, duke e përfshirë edhe zgjerimin në kthesa, rrugët lidhëse, si dhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25ton deri në masë densiteti dhe rrafshimi të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune.	m ²	1,500.00
7	Furnizimi,transporti dhe punimi i shtresës së asfalt-betonit (0-11) mm me trashësi t=7.0 cm, duke e përfshirë edhe zgjerimin në kthesa, rrugët lidhëse, si dhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25 ton deri në masë densiteti dhe rrafshimi të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune.	m ²	1,500.00

8	furnizimi dhe punimi i bankinave me guri të thyer gëlqeror 0-31.5 mm	m ³	150.00
9	Nivelizimi i kubezave, ku përfshihet heqja e kubezave neper rruge dhe trotuare, shtruarja e zhavorrit 0-31.5 mm me ngjeshje, zhavorrit fr.2, vendosja e kubezave te njëjta si dhe fugimi i tyre	m ²	2,000.00
10	Furnizimi dhe vendosja e kubëzave te reja ne hapsirat ku duhet te plotesohet te nivelizimet e kubezave te vjetra me trashësi t=8cm . Ne këtë pozicion te përfshihen rëra me trashësi 5 cm. Forma e tyre përzgjidhet nga investitori.	m ²	3,100.00
11	Furnizimi dhe vendosja e skajorëve 18/24 kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjera ngrirje shkrije-krypëra, abrazion	m'	850.00
12	Furnizimi dhe vendosja e skajorëve 10/20 kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjera ngrirje shkrije-krypëra, abrazion	m'	850.00
13	Nivelizimi i kapakëve ekzistues te pusetave, në çmim të llogaritet thyerja e kurorës, ngritja apo ulja e kapakut, si dhe betonimi i kapakut të pusetës me beton apo asfaltimi me asfalt.	copë	30 00
14	Furnizimi, transporti, montimi i kapakëve nga materiali kompozit, më aftesi mbajtëse 40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betoni C20/25.	copë	40 00

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve që duhet te performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative . Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është i detyruar të përdorë këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë, të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën **07.12.2023** dhe përfundon me datën **06.12.2026** ose nëse përmbushet vlera e përafërt dhe sasia + 30% para datës së përfundimit të kontratës të cekur më lartë.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë brenda **(15) ditë pune** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: Punët do të ekzekutohen në rrugët Kisla-Cumhuriyet-Bahcelik-Huryiet-Asker-Demirci dhe Kultur në Mamushë

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është **374,202.00 €**. Treqind e shtatëdhjetë e katërmijë e dyqind e dy Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është **[+/- 30%]**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhë Shqipe¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

Për Operatorin Ekonomik**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	Arian Bytyqi	Emri:	Gazmend Gashi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	07.12.2023	Data:	07.12.2023
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME**Neni 1****Përkufizimet**

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Punë"** konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 **"Kontraktuesi"** është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 **"Menaxheri i Projektit"** është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 **"Çmimi Kontratës"** do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 **"Vendi i ndërtimit"** do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 **"Pajisjet e kontraktuesit"** do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 **"Skicat"** nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2**Gjuha dhe ligji i aplikueshëm**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3**Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguheshin ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do t'i jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të

mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndhurma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren; dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga data fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumën e përcaktuar në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të ris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktori duhet të fillojë punimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

17.2 Kontraktuesi do të ekzekutoj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës.

Neni 18

Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19

Dëmet e likuiduara

19.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Kontraktuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e kontraktuesit.

19.2 Nëse mosdorëzimi i punëve parandalon përdorimin e zakonshëm të punëve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 19.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Kontraktuesin:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vetë Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie të pjesës së mbetur të punëve. Kontraktuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vetë Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porposinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi i gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me

- 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Materialet dhe mjeshtritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhe Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "*Menaxherin e Projektit*", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbyshjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se ai/ajo vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikime teknike gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsiderojë pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere te nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Parimet e përgjithshme të pagesave

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhën nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

24.5 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 24.2 kontraktori mund

të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jetë rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa tjera për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimi përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;

- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- (f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta lirojë vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **"Force Madhore"** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohej nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA
626-23-11039-5-2-1/C157

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të dy palëve kontraktuese.
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	Kushtet dhe detyrimet
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksion do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	3.1	Siguria e ekzekutimit është: 37,420.20 € për periudhën prej tridhjeteshtatë (37) muajve nga data e nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	4.1	Përgjegjësia e kontraktuesit është në rast të shkaktimit të dëmeve në persona, staf apo objekte për rreth. Operatori Ekonomik është përgjegjës për sigurimin e punëtorëve të tij dhe do ti bartë të gjitha pasojat në rast të ndonjë lëndimi gjatë ekzekutimit të furnizimeve, gjatë transportit dhe kryerjes së punëve dhe furnizimit për mirëmbajtje të rrugëve dhe kanalizimeve si dhe në objektet institucionale.
Cilësia e furnizimeve	5.1	Furnizimet duhet të kenë cilësi të lartë dhe duhet ti përmbahen me përpikëri specifikacionit teknik në dosje të tenderit.
Inspektimi dhe testimi	6.1	Menaxheri i Projektit do të përcaktohet me vendim të Kryetarit të Komunës.
Pagesa	7.1	Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate me të cilën vërteton pjesën e përfunduar të furnizimeve sipas kontratës.
Obligimet e garancionit	8.1	Operatori ekonomik do të ofrojë mallrat të cilat i përshtaten specifikimeve teknike në dosje të tenderit.
Dëmet	9.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0,25%] në

likuiduara		ditë, të punëve të pa dorëzuara/realizuar për një ditë vonese. Autoriteti Kontraktues mund t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Shërbimet pas shitjes	10.1	Perioda për përmirësimin e defekteve është 5 ditë pas dorëzimit të kërkesës (Vërejtjes) nga ana e Menaxherit të kontratës në rast se konstatohet që materiali nuk i plotëson specifikat teknike.
Garancioni i kualitetit të punëve	11.1	Garancioni i kualitetit të punëve do të jetë 12 muaj. Pas përfundimit të punimeve të porosituar sipas kërkesës së autoritetit kontraktues, para pagesës të secilit situacion të realizuar, kontraktuesi duhet të sjellë garancionin për kualitet të punimeve në vlerë 10% të shumës së përgjithshme të situacionit të vlefshëm për 13 muaj.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	12.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



Rregullimi dhe renovimi i asfaltit, kanalizimit dhe rrugeve me kubeza ne rruget Klsia-Cumhuriyet-Bahcelik-Huryet-Asker-Demirci dhe Kultur

Përshkrimi i Çmimit

Nr. i prokurimit: 626-23-11039-5-2-1

Nr. i brendshem: 626-23-025-5-2-1

PUNËT E RREGULLIMIT DHE RENOVIMIT

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia e përafërt indikative për 36 muaj	Çmimi për njësi pa TVSH €	TVSH (%)	Çmimi për njësi ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	Pastrimi me makine i shtrëterve të lumenjve. Pastrimi duhet të jetë i plotë duke formuar profilin e mëparshëm të shtratit, duke përfshirë pastrimin e mbetjeve dhe vegjetacionit në shtratin e lumit. Pastrimi duhet të bëhet në atë mënyrë që pamja e shtratit të lumit të duket e pastër dhe estetike. Në çmim të përfshihet edhe ngarkimi i mbetjeve dhe transporti deri në deponinë e caktuar nga inspektorati komunal. Të rastet kur lumi që pastrohet gjendet përkaj rruges apo trotuarit ekzistues, të llogaritet që pas përfundimit të punës të pastrohet edhe rruga-trotuari me uje të pastër me presion. Në çmim të përfshihet edhe sinjalizimi i duhur për devijim të trafikut.	m ²	12,000.00	0.08	18%	0.1	€ 1,200.00
2	Prerja e llsave dhe drunjeve të tjera të cilët paraqesin rrezik për banorët dhe njëedisin në përgjithësi, pastrimi i rrugëve lokale dhe trotuareve nga shkurret dhe drunjet skajor. Në çmim të përfshihet edhe ngarkimi i mbetjeve dhe transporti deri në deponinë e caktuar nga inspektorati komunal. Në çmim të përfshihet edhe sinjalizimi i duhur për devijim të trafikut.	m'	1,200.00	0.08	18%	0.1	€ 120.00
3	Pastrimi me makine dhe dore të kanaleve të hapura atmosferike me gjeresi deri në 2m. Pastrimi duhet të jetë i plotë duke formuar profilin e mëparshëm të kanalit të hapur atmosferik, duke përfshirë pastrimin e mbetjeve në kanale si dhe vegjetacionin. Pastrimi duhet të bëhet në atë mënyrë që pamja e kanalit të hapur të duket e pastër dhe estetike. Në çmim të përfshihet edhe ngarkimi i mbetjeve dhe transporti deri në deponinë e caktuar nga inspektorati komunal. Të rastet kur prroi pastrohet përkaj rruges apo trotuarit ekzistues, të llogaritet që pas përfundimit të punës të pastrohet edhe rruga-trotuari me uje të pastër me presion. Në çmim të përfshihet edhe sinjalizimi i duhur për devijim të trafikut.	m'	750.00	3.39	18%	4	€ 3,000.00
4	Të mirëmbajtja dhe të rregulloj kanalizimin e ujërave fekale, në rast të bllokimit duhet të bëhet zhblokimi dhe funksionalizimi i rrjetit sipas kërkesës së menaxherit të projektit. Gypat janë me diametër prej Ø400mm deri Ø1000mm	m'	3,500.00	2.54	18%	3	€ 10,500.00
5	Të mirëmbaje dhe të rregulloj rrjedhën e ujërave atmosferike, hapjen e kanaleve sipas kërkesës së menaxherit të projektit. Gypat janë me diametër prej Ø400mm deri Ø1000mm	m'	1,500.00	3.39	18%	4	€ 6,000.00
6	Të bëj pastrimin dhe mirëmbajtjen e pesotave të kanalizimit fekale dhe atmosferik sipas kërkesës të menaxherit të projektit	copë	75.00	16.95	18%	20	€ 1,500.00
7	Të bëj pastrimin dhe mirëmbajtjen e grilave të kanalizimit atmosferik sipas kërkesës së menaxherit të projektit	copë	80.00	8.47	18%	10	€ 800.00



8	Shërbime me ekskavator sipas menaxherit të projektit me makineri përkatëse të rende-ekskavator mbi 16 ton, me ngarkim dhe bartje të dheut deri në deponinë e investitorit	Orë pune	350.00	186.44	18%	220	€	77,000.00
9	Pastrimi i mbeturinave të ngurta dhe gjësëndeve të forta si dhe atyre të buta (organike dhe joorganike) nga deponit ilegale në terë territorin e Komunës së Mamushës si dhe largimi i tyre deri deponinë me largësi 5 km.	m ²	15,500.00	0.04	18%	0.05	€	775.00
Gjithsejtë PUNËT E RREGULLIMIT DHE RENOVIMIT							€	100,895.00
PUNËT E KANALIZIMIT								
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia e përafërt Indikative për 36 muaj	Çmimi për njësi pa TVSH, €	TVSH (%)	Çmimi për njësi ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €	
1	Prerja e asfaltit ekzistues (varësisht nga diametri i gypit), hapja e kanalit, demolimi i gypit ekzistues të demtuar ngarkimi si dhe transporti në deponi legale. Pas përfundimit të kanalit të behet vendosja e gypit dhe mbushja me shtresa të zhavorrit me ngjeshje mbushja e hapësirës rreth gypave me rere 0-8mm si dhe përfundimin mbi gypa me zhavor të gurethyesit 0-31.5mm me trashësi dhe gjerësi sa kanali, duke përfshirë edhe ngjeshjen graduale të tij në shtresa 30cm, furnizimi dhe vendosja në pjesën e kanalit të riparuar me asfalt të gatshëm AB016 me t=11cm.	m ²	4,500.00	0.08	18%	0.1	€	450.00
2	Demolimi i kubezave ekzistues (varësisht nga diametri i gypit), hapja e kanalit, demolimi i gypit ekzistues të demtuar ngarkimi si dhe transporti në deponi legale. Pas përfundimit të kanalit të behet vendosja e gypit dhe mbushja me shtresa të zhavorrit me ngjeshje mbushja e hapësirës rreth gypave me rere 0-8mm si dhe përfundimin mbi gypa me zhavor të gurethyesit 0-31.5mm me trashësi dhe gjerësi sa kanali, duke përfshirë edhe ngjeshjen graduale të tij në shtresa 30cm, furnizimi dhe vendosja në pjesën e kanalit të riparuar me kubezat ekzistuese.	m ²	2,500.00	0.17	18%	0.2	€	500.00
3	Gërmimi për hapjen e kanalit, (varësisht nga diametri i gypit), hapja e kanalit, demolimi i gypit ekzistues të demtuar ngarkimi si dhe transporti në deponi legale. Pas përfundimit të kanalit të behet vendosja e gypit dhe mbushja me shtresa të zhavorrit me ngjeshje mbushja e hapësirës rreth gypave me rere 0-8mm si dhe përfundimin mbi gypa me zhavor të gurethyesit 0-31.5mm me trashësi dhe gjerësi sa kanali, duke përfshirë edhe ngjeshjen graduale të tij në shtresa 30cm	m ³	6,000.00	0.17	18%	0.2	€	1,200.00
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të brinjëzuar SN4 HDPE							
4.1	Ø250mm	m'	300.00	0.93	18%	1.1	€	330.00
4.2	Ø315mm	m'	300.00	1.02	18%	1.2	€	360.00
4.3	Ø400mm	m'	300.00	1.10	18%	1.3	€	390.00
4.4	Ø500mm	m'	650.00	1.19	18%	1.4	€	910.00
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të betonit							
5.1	Ø400mm	m'	300.00	12.71	18%	15	€	4,500.00
5.2	Ø500mm	m'	300.00	21.19	18%	25	€	7,500.00
5.3	Ø630mm	m'	300.00	25.42	18%	30	€	9,000.00
5.4	Ø800mm	m'	300.00	4.24	18%	5	€	1,500.00
5.5	Ø1000mm	m'	250.00	5.08	18%	6	€	1,500.00
6	Sigurimi i kanalit me pahi mbrojtëse nga shembjet e dheut me punim sipas detalit në projekt.	m ²	10,500.00	0.01	18%	0.01	€	105.00
7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për pusët e kolektorit kryesor dhe pusët e ujëmbledhësve, me betonarm C20/25	m ³	75.00	8.47	18%	10	€	750.00
8	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta të pusët e kolektorit kryesor, me përpunim sipas detalit me betonarm C25/30.	m ³	55.00	8.47	18%	10	€	550.00
9	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të betonarmesë për pusët prej betonit Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikua).	copë	200.00	10.17	18%	12	€	2,400.00



10	Furnizimi, transporti, ndërtimi dhe montimi i konuseve për pusetë prej betoni Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuara).	copë	95.00	8.47	18%	10	€	950.00
11	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave prej betoni të armuar Ø400/1000mm (elemente të parafabrikuara), për formimin e pesetës së ujëmbledhësit.	copë	80.00	8.47	18%	10	€	800.00
12	Punimi dhe montimi i shkalleve prej armature Ø20 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyerje antikorrozive.	copë	200.00	0.85	18%	1	€	200.00
13	Furnizimi, transporti, montimi i kapakëve nga materiali kompozit, në aftësi mbajtëse 40 t me diametër Ø60. Në çmim të llogaritë edhe betonimi i kurorës prej betoni C20/25.	copë	95.00	16.95	18%	20	€	1,900.00
14	Furnizimi, transporti, montimi i grilave nga materiali kompozit, në aftësi mbajtëse 40t me dimenzionet 40x40 cm. Në çmim të llogaritë edhe betonimi i kurorës prej betoni C20/25.	copë	15.00	12.71	18%	15	€	225.00
Gjithsejtë PUNËT E KANALIZIMIT							€	36,020.00

PUNËT E RRUGËVE

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia e përafërt Indikative për 36 muaj	Çmimi për njësi pa TVSH €	TVSH (%)	Çmimi për njësi ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	Prerja e asfaltit ekzistues, demolimi, ngarkimi si dhe transporti në deponinë legale.	m ²	2,700.00	0.09	18%	0.11	€ 297.00
2	Furnizimi, punimi i shtresës stabilizuese me material jo-koherent të granuluar (Mv≥50MN/m ²) të trupit të rrugës 0-100mm me trashësi t=50cm me CBR>15%, sipas kërkesës së menaxherit të projektit	m ³	4,000.00	2.54	18%	3	€ 12,000.00
3	Furnizimi, punimi i tamponit (Mv≥60MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-64mm me trashësi t=25cm dhe ngjeshja me cilindër mbi 25 ton sipas standardeve dhe rregullave teknike, sipas kërkesës së menaxherit të projektit	m ³	2,800.00	8.47	18%	10	€ 28,000.00
4	Furnizimi dhe punimi i tamponit (Mv≥70MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5 mm me trashësi t=15cm dhe ngjeshja me cilindër mbi 25 ton sipas standardeve dhe rregullave teknike, sipas kërkesës së menaxherit të projektit	m ³	1,800.00	10.17	18%	12	€ 21,600.00
5	Furnizimi dhe spërkatja me emulsion e sipërfaqes punuese para asfaltimit	m ²	3,000.00	0.85	18%	1	€ 3,000.00
6	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së asfaltit binder (0-22) mm BZH22, me trashësi t=7.0 cm, duke e përfshirë edhe zgjerimin në kthesa, rrugët lidhëse, si dhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25ton deri në masë densiteti dhe rrafshimi të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune.	m ²	1,500.00	5.08	18%	6	€ 9,000.00
7	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së asfalt-betonit (0-11) mm me trashësi t=7.0 cm, duke e përfshirë edhe zgjerimin në kthesa, rrugët lidhëse, si dhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25 ton deri në masë densiteti dhe rrafshimi të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune.	m ²	1,500.00	5.08	18%	6	€ 9,000.00
8	furnizimi dhe punimi i bankinave me guri të thyer gëlqeror 0-31.5 mm	m ³	150.00	0.85	18%	1	€ 150.00
9	Nivelizimi i kubezave, ku përfshihet heqja e kubezave neper rruge dhe trotuare, shtruarja e zhavorrit 0-31.5 mm me ngjeshje, zhavorrit fr.2, vendosja e kubezave të njëjta si dhe fugimi i tyre	m ²	2,000.00	16.95	18%	20	€ 40,000.00
10	Furnizimi dhe vendosja e kubezave të reja në hapsirat ku duhet të plotësohet të nivelizimet e kubezave të vjetra me trashësi t=8cm . Në këtë pozicion të përfshihen rëra me trashësi 5 cm. Forma e tyre përzgjidhet nga investitori.	m ²	3,100.00	25.42	18%	30	€ 93,000.00
11	Furnizimi dhe vendosja e skajorëve 18/24 kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kriteret tjerë ngrirje shkrirje-krypëra, abrazion	m ¹	850.00	8.47	18%	10	€ 8,500.00



12	Furnizimi dhe vendosja e skajorëve 10/20 kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kriteret tjera ngjirje shkëlqim-kryepër, abrazion	m'	850.00	4.24	18%	5	€	4,250.00
13	Nivelizimi i kapakëve ekzistues të pusetave, në çmim të llogaritës thyerja e kurorës, ngritja apo ulja e kapakut, si dhe betonimi i kapakut të pusetës me beton apo asfaltimi me asfalt.	copë	30.00	70.34	18%	83	€	2,490.00
14	Furnizimi, transporti, montimi i kapakëve nga materiali kompozit, më aftësi mbajtëse 40t. Në çmim të llogaritës edhe betonimi i kurorës prej betoni C20/25.	copë	40.00	127.12	18%	150	€	6,000.00
Gjithsejtë PUNËT E RRUGËVE							€	237,287.00
Vërejtje: Në çmimi duhet të përfshihen punët, materialet, instalimi dhe sjellja e pozicionit dhe rrethina ku punohet, në gjendje plotësisht funksionale. Te gjithë punët dhe produktet duhet të jenë kualitative. Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detaj operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritës edhe kosto eventuale e detektimit me aparaturë elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit dhe në rast demtim të bëhet riparimi i tyre (rrjeti elektrik, rrjeti i telefonisë shtëpiake, rrjeti i ujësjellësit etj) dhe infrastruktura mbitorësore. Në çmim të përfshihet edhe sinjalizimi duhur për devijim të trafikut.								
RIKAPITULIMI								
I	PUNËT E RREGULLIMIT DHE RENOVIMIT						€	100,895.00
II	PUNËT E KANALIZIMIT						€	36,020.00
III	PUNËT E RRUGËVE						€	237,287.00
Totali i përgjithshëm duke llogaritur të gjitha taksat dhe tatimet e aplikuarat I+II+III							€	374,202.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I OPERATORIT EKONOMIK	Triangle shpk
ADRESA E PLOTE	RR. Brigada 123 pr Suhareke
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	Arian Bytyçi
POZITA	Drejtor
NËNSHKRIMI	
DATA	06.11.2023
VULA	